

URDHËR
Nr. 621, datë 8.6.2026

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË DERMATOZËS
NODULARE TË GJEDHIT (*LUMPY SKIN DISEASE*), NË SHTETIN E ITALISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës, dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) të gjitha kafshëve të gjalla të llojit gjedh dhe buajve të ujit;
- b) qumështit të papasterizuar, ku nuk është arritur shkatërrimi i virusit dhe që nuk janë marrë masat e nevojshme paraprake pas përpunimit të tij për të shmangur kontaktin e qumështit me çdo burim të mundshëm të virusit të dermatozës nodulare të gjedhit;
- c) spermës dhe embrioneve të kafshëve të llojit gjedh dhe të buajve të ujit;
- ç) miellit të mishit, miellit të gjakut, mishit të ndryshëm nga mishi i muskujve skeletorë ose kocka nga kafshët e llojit gjedh dhe nga buajt e ujit;
- d) lëkurës së patrajtuar ku nuk është siguruar shkatërrimi i virusit dhe që nuk janë marrë masat e nevojshme paraprake pas përpunimit të tij për të shmangur kontaktin e lëkurëve të patrajtuar me çdo burim të mundshëm të virusit të dermatozës nodulare të gjedhit.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e dermatozës nodulare të gjedhit (*lumpy skin disease*), të shfaqur në shtetin e Italisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3*
1.	Sardegna	Sud Sardegna	San Vito*
2.	Sardegna	Sud Sardegna	Muravera*
3.	Sardegna	Sud Sardegna	Ballao*
4.	Sardegna	Sud Sardegna	Villaputzu*
5.	Sardegna	Oristano	Paulilatino*
6.	Sardegna	Nuoro	Oniferi*
7.	Sardegna	Nuoro	Orani*
8.	Sardegna	Nuoro	Orotelli*
9.	Sardegna	Nuoro	Olzai*
10.	Sardegna	Nuoro	Orgosolo*
11.	Sardegna	Nuoro	Nuoro*
12.	Sardegna	Nuoro	Urzulei*
13.	Sardegna	Nuoro	Sarule*
14.	Sardegna	Nuoro	Dorgali*
15.	Sardegna	Nuoro	Mamoiada*
16.	Sardegna	Sassari	Bottidda*
17.	Sardegna	Sassari	Bono*
18.	Sardegna	Sassari	Benetutti*
19.	Sardegna	Sassari	Buddusò*
20.	Sardegna	Oristano	Cuglieri*
21.	Sardegna	Nuoro	Bitti*
22.	Sardegna	Sassari	Padru*
23.	Sardegna	Sassari	Burgos*
24.	Lombardia	Mantua	Porto Mantovano*

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të llojit gjedh dhe të buajve të ujit, qumështit, spermës dhe embrioneve të kafshëve të llojit gjedh dhe të buajve të ujit, miellit të mishit, miellit të gjakut, mishit të ndryshëm nga mishi i muskujve skeletorë ose kocka dhe lëkurëve të patrajtuar të kafshëve të llojit gjedh dhe të buajve të ujit për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

4. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit gjedh dhe buajve të ujit, qumështit, spermës dhe embrioneve të kafshëve të llojit gjedh dhe të buajve të ujit, miellit të mishit, miellit të gjakut, mishit të ndryshëm nga mishi i muskujve skeletorë ose kocka dhe lëkurëve të patrajuara të kafshëve të llojit gjedh dhe të buajve të ujit.

6. Urdhri nr. 620, datë 26.6.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së dermtozës nodulare të gjedhit (*lumpy skin disease*), të shfaqur në shtetin e Italisë”, shfuqizohet.

7. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri